



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "*Njësia e Prokurimit*", të cilën e përfaqëson znj, *Zizë Bujupaj*, menaxhere e Prokurimit, Rruga "*Fadil Ferati*" Nr. 121 në njërën anë; dhe

" Romay Lift " SH.P.K -nga Prishtina, të cilën e përfaqëson, z. *Shpetim Beselica*, me Nr. Rexh. Biznesi, 810152942 (ne vazhdim "*Kontraktuesit*"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDERTIMI I ASHENSORIT NE OBJEKTIN E RI TE QKMF-SE

Nr. I prokurimit	633-19-2916-1-2-1
Nr. I brendshëm	633/19/631/121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDERTIMI I ASHENSORIT NE OBJEKTIN E RI TE QKMF-SE

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total sipas kësajë kontrate është: **24580,58 €** dhe me fjalë:

Njezetekatermiepesqinetetdhjet,pesdhjetetete euro

2.2. Oferta financiare e kontraktorit e datës: **29.05.2019** është pjesë integrale e kontratës dhe bazë per pagesen e kontratës.

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.5 Të gjitha pagesat kontraktorit do të behën pas perfundimit të furnizimeve dhe punëve që janë object I kësajë kontrate dhe specifikimeve të detyrueshme teknike të parashtruara në dokumentet e dosjës së tenderit.

Neni 3 Afati I kryrjes se punimeve

3.1 Afati i kryerjes të gjitha furnizimeve dhe punimeve është 60 ditë, pas dates së nënshkrimit të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyesi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut:

Për Kontraktuesin:

" Romay Lift " SH.P.K

Emri:	<i>[Signature]</i> Zizë Bujupaj	Emri:	Shpetim Beselica
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	29/07/2019	Data:	29/07/2019
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe</i>
Siguria ekzekutimit	9.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 90 ditësh.</i>
Cilësia furnizimeve	18.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë.</i> <i>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i> <i>Kontraktori obligohet që ta bëjë mbikqyrjen dhe funksionalizimin e paisjes në fjalë deri në funksionalizimin e plote të tijë.</i>
Pagesa	20.1	<i>Pagesa do të bëhet pas furnizimit dhe montimit të paisjes.</i>
Dorëzimi	21.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore mosmarrëveshjes	31.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja me procedure gjyqësore	32.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>